



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDAJ TË TRETËVE

RELACION TEKNIK PROJEKTI I ZBATIMIT

OBJEKTI:

**“Ndërtim i godinës së re të *Back Up* për Qendrën Kombëtare të Urgjencës
Mjekësore”, në ambientet e Spitalit Rajonal Vlorë**

POROSITËS:

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I RELACIONIT TEKNIK	2
2. GRUPI I PUNËS	2
3. ADRESA E OBJEKTIT	2
4. PARCELA E NDËRTIMIT DHE POZICIONIMI I OBJEKTIT	3
5. PËRPUTHSHMËRIA ME PPV VLORE	5
6. PLANVENDOSJA E NDËRTESES	7
7. ORGANIZIMI HAPËSINOR I NDËRTESES	10

1. QËLLIMI I RELACIONIT TEKNIK

Ky relacion teknik, realizohet për objektin: ***“Ndërtim i godinës së re të Back Up për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, në ambientet e Spitalit Rajonal Vlorë***, me porositës QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE, dhe kontraktues UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, mbështetur në VKM nr. 188, datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtaritë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre".

2. GRUPI I PUNËS

Grupi i punës për realizimin e projektit në fjalë, përbëhet nga ekspertë të UPT, si vijon:

Ark.	Juljan Veleshnja	<i>Arkitekt</i>
Inxh.	Diana Lluka	<i>Inxh. Konstruktor</i>
Inxh.	Ledia Aleksi	<i>Inxh. Hidroteknik</i> <i>VNM</i>
Inxh.	Lindita Dharmo	<i>Inxh. Elektrik</i>
Inxh.	Lorenc Malka	<i>Projekti HVAC</i> <i>Projekti MZ</i> <i>Eficientë Energjitike</i>
Inxh.	Ligor Kodra	<i>Rilevimi Topografik</i>
Inxh.	Bledar Demaj	<i>Inxh. Elektronik</i>
Inxh.	Gjon Kaza	<i>Studimi Sizmik</i> <i>Studimi Gjeologjik</i>

3. ADRESA E OBJEKTIT

Objekti i ri i kërkuar, ***“Ndërtim i godinës së re të Back Up për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore”, në ambientet e Spitalit Rajonal Vlorë***, me porositës QENDRËN KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE, gjendet në veri-lindje të qytetit të Vlorës, në mjediset e Spitalit rajonal Vlorë, përgjatë rrugës *Mitaq Sallata* (Fig. 1).



Fig. 1 - Pamje satelitore e zonës ku parashikohet ndërtesa BackUp - QKUM

Zona e ndërtimit paraqitet pothuaj e sheshtë, me disnivele të papërfillshme. Zona gjendet në mjediset e Spitali rajonal Vlorë dhe aktualisht është një territor i rrethuar me mur. Zona përreth rrethohet nga ndërtesa banimi individuale me lartësi 1-2-3 kate.

Në parcelën ku parashikohet të ndërtohet, aktualisht nuk ka ndërtesa ekzistuese, në pjesën jug-perëndimore dhe jugore gjendet ndërtesa të kompleksit spitalor Vlorë.

4. PARCELA E NDËRTIMIT DHE POZICIONIMI I OBJEKTIT

Plani i Rilevimit dhe përditësimi i të dhënave në terren janë përpiluar si vijon (fig. 2).



Fig. 2 – Foto nga sipër / rilevim topografik

Në propozimin e ndërtesës së re, kërkesat janë drejtuar në lidhje me mjediset e nevojshme për kryerjen e funksionit bazë, sikurse diktohen te Detyra e projektimit, kjo si për projektimin e ndërtesës në vetvete, por dhe në harmonizimin e saj me parcelën

Lidhur me saktësimin e kufirit të parcelës së ndërtimit, grupi i projektimit bazohet te rilevimi i kryer ditën e vizitës në terren dhe faktet e mbledhura.




Fig. 3 – Planrilevimi i parcelës për zhvillim



Fig. 4 – Planrilevimi i parcelës për zhvillim – zmadhim



Fig. 5 – Mbivendosja e planistemit me Planrilevimin e parcelës për zhvillim

Planrilevimi i mësipërm i është kryer mbi dokumentin e vendosur në dispozicion (me fotokopje) mbi pasurinë:

Zona Kadastrale 8601

Indeksi i hartës VL-F-14

Vlorë

Për saktësimin e pozicionimit të ndërtesës në parcelën në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë nevojitet ende të vihet në dispozicion: *çertifikata e pronësisë, kartela dhe harta kadastrale e zonës.*

5. PËRPUTHSHMËRIA ME PPV VLORË

Parcela e ndërtimit është pjesë Spitalit Rajonal Vlorë, pjesë e *Njesisë Strukturore: VL.UB.10.546*. Plani i Përgjithshëm Vendor Vlorë, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Teritorit Nr.1, Datë 16.10.2017, për *Njësine Strukturore: VL.UB.10.546*, parashikon:

Bashkia	<i>Vlorë</i>
Njësia	<i>VL.UB.10.546</i>
Sistemi	<i>UB_Urban</i>
Kategori 1	<i>SH.Shëndetësi</i>
Lartësia në Kate	<i>10</i>
Lartësia në Metra	<i>33</i>
PDV	<i>JO</i>
Intesitet	<i>K1=1.6</i>
KSHT	<i>K1=40%</i>
KSHR	<i>0%</i>
KSHP	<i>0%</i>
Kufizime Ligjore	<i>-</i>
Sipërfaqe (ha)	<i>2.34</i>
Nenkategori 1	<i>SH.1_Zonë Spitalore</i>
Parcela_Minimale	<i>K1=0</i>
Përdorime të Lejuara	<i>SH_Shëndetësi</i>
Përdorime të Ndaluar	<i>A_Banim S_Shërbime</i>



Fig. 6 – Ekstrakt për zonën e interesuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor Vlorë

Nga sa vërehet, funksioni i kërkuar i godinës për ndërtim, është në përputhje me parashikimet e PPV Vlorë, *Shëndetësi*, duke qenë se aktiviteti kryesor i ndërtesës është në shërbim total të shëndetësisë.

6. PLANVENDOSJA E NDËRTESES

Objekti i kërkuar në Detyrën e Projektimit parashtron kërkesën e një ndërtese me 2 kate mbi tokë për akomodimin e godinës së re të *Back Up për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore* pranë mjediseve të Spitalit Rajonal Vlorë.

Bazuar në detyrën e projektimit, te aktivitetet dhe rëndësia që ka objekti, si dhe funksionet kryesore të saja, për organizimin hapësinor dhe shpërndarjen e mjediseve vërehet se organizimi linear, dhe shpërndarja e mjediseve në dy anët e korridorit, me hyrjen kryesore në mesin e fasadës gjatësore, është varianti më i kënaqshëm, si për përdorimin sa më efikas të ndërtesës por dhe në grupimin e funksioneve të ngjashme.

Parcela ku propozohet ndërtesa nuk ka një plansistemim të propozuar, ndaj dhe pozicionimi i saj synohet të integrohet mire me kontekstin duke lenë hapësirë dhe për zhvillime dhe shtime funksionesh të tjerra në mjedisin përreth.

Pozicionimi në parcelë




Fig. 7 – Pozicionimi i ndërtesës në parcelë

Në lidhje me pozicionimin e ndërtesës, në mjediset e Spitalit Rajonal Vlorë në truall në pronësi të Ministrisë së Shëndetësisë, duke synuar pozicionimin e saj sa më optimal në parcelë, propozohet të vendoset aksi gjatësor i ndërtesës paralel me rrethimin jug perëndimor të spitalit, sikurse vërehet në Fig. 7.

Pjesa e mjediseve teknike: për depozitimin e ujit për furnizim sikurse dhe në nevojë të MNZ – parashikohet nën-tokë, gjeneratorin elektrik, dhe të tjera, propozohen në pjesën midis ndërtesës dhe murit rrethues, duke synuar funksionimin sa më optimal të tyre dhe mirëmbajtje më të lehtë, sikurse dhe duke synuar në lehtësimin e ndërtesës dhe mos zënien e mjedisit përreth.

Distancat nga rrethimi

Muri jug-lindje 10.88 m

Muri veri-lindje 11.82 m

Distancat nga ndërtesat

Ndërtesa në jug-perëndim 21.95 m

Ndërtesa në veri-perëndim 29.05 m



Fig. 9 – Plansistemi i parcelës

Nga sa vërehet dhe në Planisistemimin e parcelës Fig.9, pjesa e parcelës në hyrje të ndërtesës së Back-Up të QKUM Vlorë propozon një sërë mjedisesh si gjelbërim, por edhe parkim, 21 vende parkimi në dispozicion të ndërtesës.

Pjesa e parcelës midis kabinës elektrike dhe murit rrethues veri-perëndimor organizohet me rreth 36 vende parkimi, nëse gjykohet e arsyeshme nga porositësi.

Hyrja dhe akseset kryesorë do të mundësohen nga hyrjet e Spitalit rajonal Vlorë.

Ndërtesa synohet të rrethohet në gjithë anët e saj me gjelbërim të lartë, për të siguruar një zonë filtër për pjesën akustike dhe vizuale.

7. ORGANIZIMI HAPËSINOR I NDËRTESES

Organizimi hapësinor i ndërtesës propozon 2 kate funksionale (sipas detyrës së projektimit) dhe daljen në tarracë, e cila kthehet në mjedis të shfrytëzueshëm për pjesën e impianteve dhe jo vetëm.

Kati 0

Në këtë nivel propozohet hyrja kryesore e ndërtesës dhe shpërndarja në mjediset e ndryshë nëpërmjet korridorit. Lëvizja vertikale mundësohet nga 1 ashensor sikurse dhe 1 bllok shkallësh të cilat propozohen dhe si dalje në rast emergjence dhe rënies së zjarrit, duke ofruar dhe mundësi dalje të menjëhershme në mjediset e pasme po kryqëzuar kalimet e katit të sipërm me katin përde.




Fig. 10 – Planimetria kati 0

Është kështu që kat propozohet dhe magazina/depo e cila për një funksionim sa më optimal ka akses të drejtpërdrejtë nga mjedisi i jashtëm dhe një kontakt të lehtësuar në nivel me automjetet.

Kati +1

Në këtë nivel gjendet salla e njësive të koordinimit, dhe zyra e IT me mjediset e serverit, sikurse dhe zyra. Njësia e koordinimit ka dhe mjedise shërbimi në mbështetje të aktiviteteve të zgjatura në kohë (dhoma veshje-zhveshje dhe dushe).

Salla e koordinimit ofron dhe mundësinë e një mjedisi fleksibël, për trajnime apo edhe unifikim me hapësirën tjetër, sipas nevojës.




Fig. 11 – Planimetria kati +1

Sipas kateve: Kati 0, Kati +1 dhe Kati +2 – tarracë, sipërfaqe të shfrytëzueshme:

NR.	KODI	EMETIRIMI	sip.
101	K0_16	HOLL	16.44 M2
102	K0_14	KORRIDOR	37.76 M2
103	K0_01	SALLE TRAJNIMESH	75.73 M2
104	K0-05	MAGAZINE	57.24 M2
105	K0_05	ZYRE FINANCA	27.38 M2
106	K0_05	ZYRE	28.03 M2
107	K0_06	MIREMBAJTJE PASTRIM	4.72 M2
108	K0_09	TUALET FEMRA	10.19 M2
109	K0_07	TUALET MESHKUJ	10.25 M2
110	K0_08	KUZHINA	17.61 M2
111	K0_07	UPS/ELEKTRIK	9.64 M2
112	K0_15	SHKALLA	16.87 M2
113	K0_14	SHAFT HIDRO	1.59 M2
114	K0_13	ASHENSOR	2.78 M2
115	K0_15	SHAFT ELEK	1.94 M2
305		DEPO	1.19 M2
306		DEPO	1.83 M2
			321.20 M2

NR.	KODI	EMETIRIMI	sip.
168	K1_03	TUALET DREJTOR	3.88 M2
169	K1_04	WC DREJTOR	3.83 M2
201	K1_01	SALLA E NJESISE SE KOORDINIMIT	98.77 M2
202	K1_01	SALLA E NJESISE SE KOORDINIMIT 2	26.31 M2
203	K1_02	ZYRE DREJTUESI	23.88 M2
204	K1_11	KORRIDOR	36.30 M2
205	K1_08	ZHVESHJE FEMRA	10.75 M2
206	K1_07	ZHVESHJE MESHKUJ	8.81 M2
207	K1_06	ZYRA IT	14.61 M2
208	K1_05	DHOMA E SERVERIT	23.12 M2
209	K1_09	ZYRE INFERMIER	27.87 M2
210	K1_06	TUALET MESHKUJ	11.01 M2
211	K1_08	TUALET P.A.K.	4.72 M2
212	K1_07	TUALET FEMRA	10.90 M2
213	K1_10	SHKALLA	16.87 M2
214	K1_12	ASHENSOR	2.78 M2
215	K1_13	SHAFT HIDRO	1.69 M2
216	K1_14	SHAFT ELEK	2.01 M2
			328.10 M2

NR.	KODI	EMETIRIMI	sip.
301	K2_01	SHKALLA	20.64 M2
302	K2_02	ASHENSOR	2.78 M2
303	K2_03	SHAFT HIDRO	1.44 M2
304	K2_04	SHAFT ELEK	1.65 M2
			26.52 M2

Fasada

Për një funksionim sa më optimal dhe një raport të kontrolluar me diellin, një sërë analizash evidentojnë nevojën e elementeve hijezues të cilët kontrollojnë depërtimin e rrezeve të diellit të drejtpërdrejta në mjedisin e brendshëm.




Fig. 12 – Intervali diellëzim-hijezim 21 qershor dhe 21 dhjetor, pamja nga sipër




Fig. 13 – Fasada jug-lindore: Intervali diellëzim-hijezim 21 qershor dhe 21 dhjetor / paradite

Janë parë disa mundësi për hijezues në fasadën kryesore të cilët të mund të ishin sa më efikas në rolin e tyre.




Fig. 14 – Alternativa hijezimi Fasada kryesore veri-perëndim: Intervali diellëzim-hijezim 21 qershor 13:00-18:00

Në vijim shfaqet varianti përfundimtar i hijezuesve në fasadën kryesore, propozim i cili kënaq si pjesën funksionale ashtu dhe atë estetike, duke synuar propozimin e një ndërtese bashkëkohore.




Fig. 15 – Hijezimi Fasada kryesore Intervali diellëzim-hijezim 21 qershor dhe 21 dhjetor / pasdite



Fig. 16 – Fasada kryesore veri-perëndim



Fig. 17 – Fasada jug-lindore

Fasada e ndërtesës propozohet ‘me kapotë’ duke synuar uljen e humbjeve termike të saj, kombinuar me vetratat me dopio xham termik.




Fig. 18 – Prerje e tërthortë 2-2

Në aspektin estetik, ndërtesa propozohet e bardhë me elementët hijezues të cilët ndikojnë në artikullimin e fasadës si dhe imazhin e saj. Ritmi i krijuar, ngjyra e elementeve hijezues, krijojnë imazhin e një ndërtese bashkëkohore, të denjë për institucionin porositës.



Fig. 19 – Pamja/materializimi i fasadës veri-perëndimore

Hartoi relacionin e projektit arkitekturor:

Ark. Juljan VELESHNJA